

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE Departamenti i përgjithshëm, me Gjyqtarin Gezim Ademi, procesmbajtëse Hasnije Muhaxheri, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit B.Xh, nga ... tani jeton ne ... rruga "...", për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par 3 lidhur me par 1 te KPRK-ës, si dhe vepra pena kanosja nga neni 185 par 2 lidhur me 1 te KPRK-se, ne bashkim real si ne piken 1 te dispozitivit te aktakuzës, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1461/2018, dt.08.05.2018, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me dt.25.04.2019, ne mungese te prokurorit e ne prezence te pandehurit ne te njëjtën date publikisht shpalli, e me datë 26.04.2019, merre këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari;

I pandehuri: B.Xh , nga i ati Zh. , e ëma V. , e gjinisë Xh., i lindur me ..., me numër personal ..., me vendbanim ne ..., ne rrugën "...",Serb banor i Kosovës , i martuar sipas profesionit punëtor, i martuar, ka te kryer shkollën e mesme .

I

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me dt. 14.04.2017 rreth orës 23:14 ne shtëpinë e përbashkët familjare e cila gjendet ne rrugën "... ne ..., ka sulmuar personat e tjerë dhe atë fëmijën e tij te mitur- te dëmtuarën D.K, ashtu qe ne gjendje te dehur kinse e mitura po vonohet ne mbrëmje kur del ne qytet, atëherë i pandehuri e merr telefonin dhe e gjuan me telefon po nuk ka arritur te godas pasi qe e mitura ka qene e mbuluar me jorgan , pastaj tenton ta godas edhe me shishe te rakisë e nga frika e dëmtuara del ne korridor, ku i pandehuri e godet me grushte ne koke me c' rast e dëmtuara ike ne banjë nga frika dhe e thërret policinë, e ku tek e dëmtuara i pandehuri ka shkaktuar frike dhe ankth dhe pasiguri për jetën e saj.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Sulmi nga neni 187 par. 3 lidhur me par. 1 te KPRK-es.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 7,8,9,10,21,41,49,50,51,73, dhe 187 par 3 lidhur me par 1 te KPRK-ës dhe nenin 365, 450, dhe 463 te KPP-ës e:

G J Y K O N

ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 6 (gjashte) muaj, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatjeje prej 2 (dy) vite.

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, ndërsa ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shume prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike -kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

II

Në kuptim të nenit 363, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 të Kodi i Procedurës Penale (KPP),

REFUZOHET AKUZA

Sepse: Në te njëjtin dite vend dhe kohe si ne piken I te dispozitivit i pandehuri ka kanosur seriozisht personin tjetër me fjale se do t'i shkaktoj ndonjë te keqe, i pandehuri ne gjendje te dehur, kanos te dëmtuarën bashkëshorten e tije V.K, e ka kërcënuar se babait te saj do i'a djeg shtëpinë, ndërsa vëllain e saj do ta vras,

Me çka do te kryente veprën penale Kanosja nga neni 185 par.2 lidhur me 1 e ne bashkim real si nen piken 1 te dispozitivit te kësaj aktakuze.

Shpenzimet e procedurës bien barre te kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.1461/2018,te dt.08.05.2018, kundër te pandehurit B.Xh nga ..., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par. 3 lidhur me par.1 te KPRK-es. Si dhe veprën penale kanosja nga neni 185 par 2 lidhur me 1 te KPRK-se.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.25.04.2019, ashtu qe ne këtë seance i pandehuri lidhur me fajësinë ka deklaruar: se e ndjej veten fajtor për veprën penale Sulm nga neni 187 par 3 lidhur me par 1 te KPRK-ës, dhe njëherit me vjen keq për rastin qe ka ndodhur dhe i premtoj gjykatës se nuk do te përsëris vepra penale te tilla dhe te ndryshme dhe njekosisht i kërkon falje te dëmtuarës, dhe kemi raporte shume te mira dhe gjithë kohen për te mundohem dhe punoj.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori deklaroi :Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit nga se pranimi i fajësisë është ne përputhje te plote me faktet e çështjes qe e përmban aktakuza dhe se i njëjti është bere me vullnet te plote pa

presion pa kërcenim, dhe njëherit i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi që i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bënë në mënyrë vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e Gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje të qarte ligjore apo gabime faktike që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, të gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë në përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës si: shkresat sipas raportit policor ... të dt. 15.04.2018, raportet policore, deklaratat e të dëmtuarve, raporti mbi ekzaminimin e alkotestit në gjak si dhe vështrimin në shkresat dhe foto dokumentacioni i lëndës. Nga të gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale: Sulm nga neni 187 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-es.

Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo veprë penale është e dënueshme prej gjashtë(6) muaj deri në tri (3)vjet, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale. Si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i tij me rastin e pranimin të fajësisë i njëjti deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurit për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale, po ashtu edhe raportet në mes tyre ishin të mira. Nga të gjitha këto rrethana kjo gjykatë vlerëson se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit.

Gjetjet e gjykatës për piken II të dispozitivit të aktakuzës.

Gjykata lidhur me piken II të dispozitivit të aktakuzës ka vendosur me aktgjykim refuzues në bazë të nenit 363 par 1 pika 1.1 të KPPK. ngase prokuroria e shtetit në seancën e datës 25.04.2019, ka deklaruar se heqë dorë nga ndjekja e mëtejme penale, kundër të pandehurit B.Xh, në drejtim të veprës penale kanosja nga neni 185 par 2 lidhur me 1 të KPRK-se. ngase në këtë seancë e dëmtuara V.K. deklaroi se heqi dorë nga ndjekja penale ndaj të pandehurit B.Xh, për veprën penale Kanosje nga neni 185 par 2 lidhur me par 1, në bashkim real si në piken 1 të dispozitivit të aktakuzës, nga se e njëjta nuk dëshiron që bashkëshorti i saj të ndiqet penalisht për këtë veprë

penale. Gjykata e vlerësoj pretendimin e prokurores për heqjen dore nga vepra penale si ne piken II te dispozitivit te aktakuzës për faktin se prokuroria e shtetit ne çdo fazë te procedurës mund te heq dore nga ndjekja penale për veprat penale për te cilat ka ngritur aktakuzë, dhe se heqja dore nga ana e prokurorisë nuk ka shkelje te dispozitave ligjore. andaj gjykata duke marr parasysh faktet e çështjes dhe provat qe gjenden ne shkresat e lendes vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi sa i përket pikës II te aktakuzës.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimeve procedurale-paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 Euro, dhe ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shume prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365,363, 450,463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P. nr.355/2018 dt.26.04.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari :
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate